



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Më datë 11.04.2017, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Stacionin Policor Makedonski Brod, e cila filloi në ora 12:00, ndërsa përfundoi në ora 15:00.

Vizita rezulton nga mandati i Avokatit të Popullit - Mekanizmit Parandalues Nacional, i parashikuar në Protokollin Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit. Me Protokollin Fakultativ përkufizohet realizimi i rregullt i vizitave në vendet në vendet ku mund të kryet privimi nga liria, me qëllim të identifikimit të rreziqeve për shkak të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimeve brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

Ekipi i MPN kishte bashkëpunim dhe kooperim të mirë nga ana e nëpunësve zyrtarë të punësuar në Stacionin policor, të cilët mundësuan qasje papengesë deri te të gjitha hapësirat dhe instalimet, si dhe këqyrje në dokumentacionin e kërkuar.

Ekipi i MPN-së u njoftua se për nëpunësit policorë organizohen trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme me përmbajtje tematike nga më të ndryshmet.

Ekipi i MPN-së, gjithashtu, konstatoi se SP Makedonski Brod ka në dispozicion rampë të aksesshme, në hyrjen e prapme të stacionit policor, me çka personave me aftësi të kufizuar u mundësohet qasje e lehtë deri në brendinë e stacionit policor.

Ekipi i MPN-së në SP Makedonski Brod konstatoi se ky stacion policor nuk ka hapësirë të posaçme për marrjen në pyetje të personave të ndaluar dhe personave të privuar nga liria, e as nuk ka hapësirë të posaçme për ndalimin e personave të mitur, konform Ligjit për të drejtat e fëmijëve.

Ekipi i MPN-së konstatoi se hapësira për ndalim nuk i përmbush standardet e parashikuara minimale të personave, ndërkohë që problematike është edhe hapësira për të cilët theksohet se nuk është në funksion, megjithatë nuk është e mbyllur, me ç'rast nuk përjashtohet mundësia se e njëjta është përdorur, apo se ende përdoret për ndalimin e personave.

Gjatë vizitës u konstatua se asnjëra nga hapësirat në të cilat kryhet marrja në pyetje e personave të arrestuar dhe personave të privuar nga liria nuk disponojnë me sistem për audio ose video monitorim.

Ekipi i MPN-së u informua se në rastet e ndalimit të personave në SP Makedonski Brod, i cili zgjatë më shumë se 6 orë, nuk sigurohet buxhet i veçantë për ushqim, kështu që në të shumtën e rasteve personave të ndaluar ushqimi sigurohet me mjete të tyre personale ose me mjete të nëpunësve zyrtarë.

Ekipi i MPN-së konstatoi se në Stacionin policor nuk janë theksuar udhëzimet për të drejtat e personave të ndaluar dhe personave të privuar nga liria, në të gjitha hapësirat ku zhvillohen biseda me këta persona.

Po ashtu, u vërejtën lëshime në aspekt të mos-evidentimit të personave në Regjistrin e personave të arrestuar, Regjistrin e personave të privuar nga liria dhe personave të ndaluar edhe pse këta dy regjistra duhet të jenë në përputhje me njëri tjetrin.

Për këtë vizitën Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi Raport të posaçëm në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe adresoi rekomandime konkrete deri te Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe deri te komandanti i Stacionit Policor në SP Makedonski Brod, me qëllim që të eliminohen mangësitë e konstatuara dhe të përmirësohen kushtet sa i përket trajtimit të personave të privuar nga liria dhe personave të arrestuar dhe të ndaluar.